



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:238581
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05847333

C-IV.-14-3000

Ankuesi

V J nga f.sh A K.Kamenicë.

Kundër

E paditura

N.SH “XIQ Karaqeva”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), sipas gjyqtarit Murat Hulaj, me dt.18 qershor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e ankuesit, dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.GJI045-0687 i dt.13 mars 2014.
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.18 prill 2014, ankuesja parashtroj ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit GJI045-0687 i dt.13 mars 2014, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për paga të pa paguara për periudhën maj – korrik 2006 në shumë prej 900.00€ nga NSH “XIQ Karaqeva” (në likuidim). Ankuesja në ankesë ka pohuar se e ka marr 20% dhe ka qenë punëtore e NSH-së. Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ka marr me dt.15 gusht 2006. Ka kërkuar që të anulohet vendimi i AL-së dhe të i kompensohet pagesa e pagave. Të njëjtës i ka bashkangjitur Kopjen e vendimit të atakuar, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me dt.01 nëntor2023, e paditura AKP ka parashtruar mbrojtje ku ka pohuar se vendimi i AL nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore në fuqi janë zbatuar drejtë. Konsideron se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të kundërshtuar. Parashtruesi nuk ka treguar se cilin nen e ka shkelur AL me vendimin e saj dhe nuk ka ofruar asnjë argument ligjor. Ka kërkuar që në bazë të dispozitave ligjore, gjykata ta refuzoj ankesën e ankuesit.

Me dt. 04 prill 2024, gjykata ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e provave shtesë dhe atë: të bëjë dorëzimin e kopjes së librezës së punës, kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe listën e pagave si dhe prova tjera që dëshmojnë pretendime ankimore. I njëjti e ka pranuar urdhrin me dt.29 prill 2024, dhe deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Arsyetime ligjor

Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesja ka qenë punëtore e NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara për periudhën maj – korrik 2006. Ankuesja ka dorëzuar Kopjen e vendimit të atakuar, Kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ankuesja ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj edhe pas parashtrimit të urdhrin të dt.04 prill 2024.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesja e ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesja do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të saj ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa ka punuar për NSH-në, si dhe cila ka qenë paga të cilën ankuesja e ka pranuar nga e njëjta. Gjkata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për paga të pa paguara për periudhën maj – korrik 2006, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Ankuesja e ka bërë dorëzimin e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës e cila nuk dëshmon të drejtën e pretenduar, andaj dhe pretendimet e saj nuk janë të bazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Në pajtim me nenin 13 par.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr.01/2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore, pasi që vlera e kontestit është nën 1.000€.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r i,
Dr.sc.Murat Hulaj
